



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.154/13 prot.

Datë 26.04.2024

V E N D I M
Nr. 430/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*F.L.E.SH*” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-91142-12-15-2023 me objekt: “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 1,484,255.00 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 28.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe adresë: Rruga “Siri Kodra”, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Mjekësisë Tiranë me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005 – Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “*F.L.E.SH*” SHPK me NIPT J91801004M dhe adresë Rruga: “Nikolla Lena”, ish Merkato e "21 Dhjetorit", Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.12.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-91142-12-15-2023 me objekt: “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 1,484,255.00 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 28-12-2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

II.2. Në datën 28.12.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 15.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“OE “ONUFRI” SHPK	836,200 lekë pa TVSH	skualifikuar
2-OE “F.L.E.SH” SHPK	940,725 lekë pa TVSH	kualifikuar
3-OE “Inpress” SHPK	1,061,974 lekë pa TVSH	kualifikuar
4-OE “FILARA” SHPK	1,325,377 lekë pa TVSH	kualifikuar
5-OE “KRISTALINA.KH” SHPK	1,410,720 lekë pa TVSH	kualifikuar

II.4. Në datën 18.01.2024, është publikuar Njoftimi i Fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 23.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 154 prot., e Operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, si dhe në datën 23.01.2024 pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK si më poshtë vijon:

“[...]Së pari operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët.

Së dyti kemi bindjen që OE FLESH shpk në kundërshtim me pikën 2.3.3 “kapaciteti teknik” të shtojcës 7, kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrat në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

[...]Ne kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga OE F.L.E.SH shpk nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, formulari i specifikimeve teknike dhe të kërkuara në shtojcën 7 “kriteret e veçanta të kualifikimit”-kapaciteti teknik pika2.3.3 të DST, përse i përket elementëve përbërës të tyre, sa vijon:

- i. Përmasave*
- ii. Printime mbi karton*
- iii. Stampimeve mbi karton*
- iv. Elementëve të sigurisë*
- v. Të dhëna të hologramës (pulla)*

Për këtë arsye kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të verifikimit dhe testimit të të gjithë

elementëve përbërës të dy mostrave të dorëzuara nga OE FLESH shpk nga laboratorë të akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përputhshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të DST.

Së treti, mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST dhe rregullat e prokurimit publik OE FLESH SHPK ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë ankesë dhe përsa i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu mendojmë që OE FLESH shpk nuk ka paraqitur/dorëzuar në sistemin SPE të APP, një vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike.....

[...]Në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik kërkojmë:

Verifikimin dhe testimin e mostrave të paraqitura nga OE FLESH, nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, përsa i përket:

- 1. Të gjithë elementëve përbërës dhe proceseve teknike si: përmasat, dizajni, ngjyra, relievi, elemnt sigurie etj., të përcaktuara në shtojcën 5, të DST:*
- 2. Llojit dhe peshës së letrës së Diplomave: “letër 300gr/m2 superfine”*

Pasi kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 dhe të kërkuara në shtojcën 7 të DST.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.154/2 prot., datë 24.01.2024, lidhur me kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik “Inpress” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK.

II.7. Me shkresën me nr. 3625/25 prot., datë 31.01.2024, protokolluar me tonën me nr.154/3 prot., datë 02.02.2024 me lëndë “Vendim”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë, ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Inpress” SHPK nga ku rezulton, se e ka refuzuar atë.

II.8. Me shkresën me nr. 154/4 prot., datë 15.02.2024, drejtuar autoritetit kontraktor, Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK pranë tij, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkesën për sqarime mbi ofertën anomalisht të ulët drejtuar operatorit ekonomik FLESH SHPK, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “FLESH” SHPK, si dhe procesverbalin e dorëzimit të mostrave nga operatori ekonomik dhe mostrën e dorëzuar nga

ky i fundit për artikullin “Diplomë horizontale dhe diplomë vertikale, së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj.

II.9. Me shkresën me nr. 3625/27 prot., datë 20.02.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.154/5 prot., datë 22.02.2024 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuse të Universitetit të Mjekësisë Tiranë”, autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin si vijon: “[...]Procesverbalin e hapjes së ofertave dhe dorëzimin e mostrave me nr. 3625/10, datë 28.12.2023:

Shkresën me lëndë “Kërkesë për sqarim në lidhje me ofertën ekonomike anomalisht të ulët”, me nr. 3625/12 prot., datë 05.01.2024:

Dokumentacionin i dorëzuar nga operatori ekonomik FLESH shpk me nr. 3625/14 prot., datë 08.01.2024:

Mostra të dorëzuara nga operatori ekonomik “F.L.E.SH” shpk”.

II.10. Me shkresën me nr. 154/6 prot., datë 08.03.2024, drejtuar autoritetit kontraktor, Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK pranë autoritetit kontraktor, në përmbushje të nenit 85 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.11. Me shkresën me nr. 3625/29 prot., datë 12.03.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 154/7 prot., datë 13.03.2023 me lëndë “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë Tiranë”, autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka dorëzuar informacionin si vijon: “[...]bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar si më poshtë vijon: - Lista e dokumentacionit të operatorit “Flesh” shpk në mbështetje të nenit 2 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 26 të vendimit të këshillit të ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

II.12 Me shkresën me nr. 154/8 prot., datë 05.04.2024 drejtuar shoqërisë “Eko Studio Projekt” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar laboratorit të akredituar Eko Studio Projekt SHPK informacion lidhur me kryerjen e analizave të materialeve (diplomë format vertikal dhe diplomë format horizontal), nëse ndikon në peshën e letrës, në rastin kur letra është e stampuar sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

II.13 Me shkresën datë 11.04.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 154/9 prot., datë 12.04.2024 me lëndë “Kërkesë”, operatori ekonomik Flesh SHPK ka informuar si vijon: “[...]në mostrat që ne kemi paraqitur janë integruar të gjithë elementët e kërkuara në një cilësi tepër të lartë. Kërkojmë tju bëjmë me dije se kompania jonë ka qënë fituese për prodhimin e diplomave para dy viteve dhe e ka realizuar me sukses, pasqyruar kjo dhe me kontratën e ngjashme dhe vërtetimin e realizimit të lëshuar nga Universiteti i Mjekësisë.

Vo: Modeli përfundimtar kërkohet në një moment tjetër, kur nga autoriteti kontraktor të na dorëzohet dizajni i miratuar, pas lidhjes së kontratës.

Pra theksojmë, që modelet e gjithëkujt, përfshi dhe tonat, nuk janë modele përfundimtare dhe për më tepër nuk janë objekt analizimi i imtësishëm nga laborator i akredituar “Eko Studio Projekt” pasi ky laborator ka aftësinë të analizojë vetëm peshën e letrës dhe jo specifikimeve të tjera të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Përsa i përket peshës së letrës, ajo nuk është kurrë e njëjtë në produktin përfundimtar pasi çdo element i shtuar në të, ndikon në peshën përfundimtare. Kështu që mostrat nuk janë objekt analizimi.

Kërkojmë nga Komisioni i Prokurimit Publik të mos marrë parasysh kërkesën e ankimuesit INPRESS pasi bie ndesh me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruara në DST si dhe ndërprerjen e analizimit të modeleve tona.”

II.14 Me shkresën me nr. 347 prot., datë 19.04.2024, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 154/10 prot., datë 22.04.2024 me lëndë “Kthim - përgjigje shkresë me nr. 154/8 prot., datë 05.04.2024” laborator Eko Studio Projekt na informon si vijon: “[...]Për sa është thënë më sipër ju sqarojmë se, nisur nga elementet shitesë mbi karton si printimet, stampimet, logot dhe holograma mbi karton, mund të ndikojnë në disa mënyra lidhur me peshën e letrës:

Printimi mbi karton mund të ndikojë në disa mënyra:

- 1. Cilësia e imazhit: Nëse printimi është i një cilësie të lartë dhe përdor shume ngjyra të dendura ose grafika komplekse, kjo mund të rrisë peshën e kartonit.*
- 2. Ngjyra e bojës: Për përdorimin e ngjyrave të ndryshme, vecanërisht atyre të ndritshme dhe të dendura, mund të nevojitet kjo shtresë e madhe boje për të arritur ngjyrën e dëshiruar, duke shtuar kështu peshën e kartonit.*
- 3. Ndërveprim me materialin: Disa lloje bojërash mund të përshkruhen thellë në sipërfaqen e kartonit, duke e bërë atë të duket më e trashë ose të ndihet më e ngurtë.*
- 4. Struktura e materialit: Duhet të kemi parasysh që materiali super fin i kartonit ka një strukturë shumë të hollë dhe cilësia e printimit ndikon në dukjen e prgjithshme të kartonit.*

Stampimi në karton mund të ndikojë në disa mënyra:

- 1. Përmbajtja e bojës: Nëse stampimi përfshin grafika të dendura ose tekst me bojë të trashë, kjo mund të rrisë peshën e kartonit.*
- 2. Sasia e bojës: Për disa lloj stampimesh sic është stampimi offset, aplikimi i sasissë së madhe të bojës mund të shtojë në peshën e kartonit.*
- 3. Ngjyra e bojës: Nëse aplikohet një shtresë e madhe boje ose ngjyra të shndritshme dhe të dendura, kjo mund të shtojë në peshën e kartonit.*
- 4. Përpunimi i stampimit: Teknikat e stampimit, sic janë prerja ose formimi i ngjyrave mund të ndikojë në strukturën dhe peshën e kartonit.*

Referuar aplikimit të elementëve të sigurisë logos UV mbi karton ky element ndikon në disa mënyra:

1. *Peshimi: Aplikimi i një logoje UV mund të ndikojë në peshën e letrës nëse përdoret një sasi e madhe boje për të arritur efektin e dëshiruara.*
2. *Ngjyra e bojës: Nëse logoja UV aplikohet me sasi të madhe boje ose ngjyra të dendura, kjo gjithashtu mund të ndikojë në peshën e kartonit.*
3. *Ndërveprimi me materialin: Aplikimi i një logoje UV mund të ndikojë në teksturën e sipërfaqes së kartonit, duke e bërë atë më të trashënë dukje ose në prekje më të ngurtë.*
4. *Rezistenca ndaj ndryshimeve të temperaturës: Materiali super fin mund të ketë një ndjeshmëri ndaj ndryshimeve të temperaturës, kështu që aplikimi i tyre duhet të bëhet me kujdes për të minimizuar ndikimin e tyre në cilësinë dhe peshën e kartonit.*

Referuar aplikimit të halogramës (pullës) mbi karton material super fin, ky element mund të ndikojë në disa mënyra:

1. *Peshimi: Aplikimi i pullave mund të shtojë pak në peshën e kartonit, vecanërisht nëse pullat janë të përforcuara me materiale shpesë ose bojë.*
2. *Ngjyra e pullave: Nëse pullat aplikohen me ngjyra të shndritshme ose ngjyra të dendura, kjo gjithashtu mund të ndikojë në peshën e kartonit.*
3. *Struktura e kartonit: Aplikimi i pullave mund të ndikojë në strukturën e sipërfaqes së kartonit, duke e bërë atë të duket më e trashë ose në prekje më e ngurtë.*
4. *Rezistenca ndaj ujit: Nëse pullat aplikohen me produkte që kanë ndikim në strukturën e kartonit, kjo gjithashtu mund të ndikojë në rezistencën e kartonit ndaj ujit. ...*

II.15 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “F.L.E.SH” SHPK me argumentin, se “ [...]*së pari, operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK ka paraqitur një ofertë anomalisht të ulët*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 2 “Lista e çmimeve”, parashikohet si më poshtë vijon:

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia Cope	Çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.	Diploma sipas formatit Horizontal	1,411			
2.	Diploma sipas formatit Vertikal	2,770			
Çmimi total (Mallrat)					_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

III.1.2. Në shtojcën 5 “ Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **Diplomat do të jenë me letër 300 gr/m², super-fine**

- **Formati vertikal**
 - a. Përmasat
 - me përmasa të letrës (a x b) - 22.4 x 33.3 cm.
 - me kornizë të jashtme (perimetrare) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.
 - me kornizë të brendshme (perimetrare) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.
 - me kornizë të brendshme (perimetrare) në ngjyre argjendi, me gjerësi 3 mm.
 - me kornizë të brendshme, ku do të realizohen printimet, me përmasa (a x b) – 17.0 x 27.9 cm.

- **Formati Horizontal**
 - a. Përmasat
 - me përmasa të letrës (a x b) – 33.3 x 22.4 cm.
 - me kornizë të jashtme (perimetrare) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.
 - me kornizë të brendshme (perimetrare) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.

- me kornizë të brendshme (perimetrare) në ngjyre floriri, me gjerësi 3 mm.
 - me kornizë të brendshme, ku do te realizohen printimet, me përmasa (a x b) – 27.9 x 17.0 cm.
- **Printimet mbi karton:**
- Printim i dixhitalizuar i të dhënave në Diplomë me 4 ngjyra LASER-cmyk (kategorikisht jo printime ink). Sfond 97-98 % 4-color-cmyk, hapësira e printimit mbi karton sipas përcaktimeve të formateve horizontale dhe vertikale.
 - Mbi të gjithë sipërfaqen vendoset një shtresë e konfiguruar Universiteti i Mjekësisë, Tiranë , Republika e Shqipërisë me shkrim të minimizuar që nuk lexohet me sy të lirë, duke veshur të gjithë pjesën e bardhë të diplomës
 - Nr.serie me ngjyrë të kuqe, Nr. i diplomës së studimeve të mëparshme dhe Nr. unik i identifikimit të diplomës me ngjyre te zezë.
- **Stampimet mbi karton:**
- Logo e Republikës duhet të jetë me tre ngjyra, stampim i nxehte (varak).
 - Stampimi i emërtesës DIPLOMË (1cm x 6,5 cm), me thellësi të goditjes 0,5 mm
 - Stampimi i emërtesës DEKANI (0,4cm x 2 cm) dhe REKTORI (0,4cm x 2,2cm) me thellësi të goditjes 0,5 mm.
 - Shiriti i kornizës së brendshme (perimetrare) me gjerësi 3 mm me stampim të nxehtë dhe kuposje.
- **Elemente sigurie:**
- Logo e UMT-së, formati 2,2 cm x 1cm në fund të kartonit (si në modelin e skanuar bashkëlidhur) holograme me refleks ngjyrë argjendi në diplomat vertikale dhe me refleks ngjyrë floriri në diplomat horizontale.
 - Në sipërfaqen e diplomës të vendoset logo U-Vizibël me përmasa 12 cm x 5 cm. Të gjitha elementet shfaqen me reflekse të ndryshueshme sipas planit të shikimit.
 - Pulla duhet të ketë elemente sigurie të dukshme dhe të maskuar (holografikë dhe joholografikë) që sigurojnë vlerësimin e origjinalitetit të saj Ngjitje holograme 2-color rrethore \varnothing 25 mm. Pulla përgatitet me material vetë-ngjitës, që prishet nëse tentohet të çngjitet;
- **Të dhënat e hologramës(pulla) si më poshtë:**
- Në Diplomate vertikale pulla ka formë rrethore me diametër \varnothing 25 mm, ngjyrë argjendi dhe me goditje germat UMT. Germat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë argjendi;
 - Në Diplomate horizontale pulla ka formë rrethore me diametër \varnothing 25 mm, ngjyrë floriri dhe me goditje germat UMT . Germat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë floriri;

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 3625/12 prot., datë 31.10.2023, si dhe nga verifikimet në

sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “F.L.E.SH” SHPK, është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte KVO i është drejtuar operatorit ekonomik “F.L.E.SH” SHPK me kërkesë për sqarim për oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.4. Në përgjigje të kërkesës së KVO, me shkresën datë 08.01.2024 me objekt: “Lista e dokumenteve që përmban zarfi”, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 3625/14 prot., datë 08.01.2024, operatori ekonomik “F.L.E.SH” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka argumentuar si më poshtë:

“ [...]Shtypshkronja Flesh ka realizuar me sukses në vitin 2022 prodhimin e diplomave për UMT, vërtetuar kjo me dokumentin që kemi paraqitur në dokumentet e tenderit, përfshi dhe modelet e diplomave të UMT që kemi dorëzuar në datën e hapjes.

Për këtë arsye ne kemi gati lastrat, klishetë të cilat zënë një kosto të konsiderueshme për riprodhimin me cilësi dhe në kohë reale të diplomave.

Shtypshkronja Flesh merr përsipër kontaktet me të gjitha fakultetet për numrat e serisë, origjinalitetin e modeleve prodhimin paraprak të mostrave, si dhe transportin sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë.

Shtypshkronja Flesh disponon të gjithë makineritë e domosdoshme për prodhimin e diplomave si:

-Makineri për shtypin e diplomave Offset Heidelberg SM 52/2

-Makineri për numëror (shtyp i lartë) heidelberg

*- Makineri për shtypin e nxehtë, kuposjen dhe hologramin format 35*50*

-Printer digital color RICOH PRO C5100S

- Thike për prerjen e diplomave

Stafi ynë ka përvojën për prodhimin e tyre në mënyre cilësore dhe pa gabime.

Shtypshkronja FLESH është certifikuar ISO 9001-2015 nga AQSCERT që nga viti 19.03.2022 ISO 9001-2015 është një standard i njohur globalisht për menaxhimin e cilësisë. Ndihejmon organizatat e të gjitha madhësive dhe sektorëve të përmirësojnë performancën e tyre, të takojnë klientët.

3. Origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ana juaj, zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Shtypshkronja Flesh furnizohet nga furnitorë të njohur shqiptare me letër dhe materiale europiane të certifikuara për cilësinë e tyre.

Bojra printeri origjinalë RICOH të certifikuara nga CE.

Shtypshkronja FLESH ka marrë masat për mbrojtjen dhe sigurinë dhe kushtet e punonjësve si bombulat për shuarjen e zjarrit, kutinë e ndihmës së parë, instruktimin e punonjësve për sigurinë në punë etj.

Jemi të instruktuar nga AQSCERT dhe jemi dhe jemi të pajisur me certifikatën që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit të sigurisë në punë ISO 45001:2018

Kjo certifikatë ofron një kornizë të njohur ndërkombëtarisht për menaxhimin e rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai u mundëson organizatave të vlerësojnë sistematikisht....”.

Bashkëngjitur kësaj shkrese, operatori ekonomik “FLESH” SHPK ka paraqitur në autoritetin kontraktor analizën e kostos për zërat e sipërpërmendur; fatura tatimore, deklaratë “Listpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe certifikatat ISO 9001:2015, ISO 45001-2018.

III.1.5. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.6. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.7 Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “FLESH” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 940,725 lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën

anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis. Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë mundësinë e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; *“Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”*. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe

dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.8. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të fashikullit administrativ rezulton, se Komisioni i Vlerësimit të Ofertës në datën **05.01.2024**, me anë të shkresës me lëndë “*Kërkesë për sqarim lidhur me ofertën ekonomike anomalisht të ulët të paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësinë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”*”, i ka kërkuar operatorit ekonomik “FLESH” SHPK “[...]shpjegime për elementë të veçantë të ofertës tuaj për anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara , zgjidhjet teknike të ofruara si dhe në ratse të vecanata dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ju keni, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve të propozuara nga ana juaj, zbatueshmërinë e etyimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të furnizohet furnizimi”. Me anë të shkresës datë **08.01.2024**, me shkresën me lëndë “Kthim - përgjigje kërkesës për sqarim lidhur me ofertën ekonomike anomalisht të ulët të paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, operatori ekonomik “FLESH” SHPK, ka paraqitur informacion në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, nga e cila rezulton, se ky i fundit krahas sqarimit narrativ ka paraqitur dhe një analizë të përlllogaritjes së çmimeve të shitjes dhe ofertat/kuotimet që kanë marrë nga prodhuesit direkt të këtyre materialeve, konkretisht oferta lëshuar nga shoqëria “4 E- Color” SHPK, e cila mban datën **05.01.2024**, faturë elektronike nr. 1508/2023, datë 1.05.2023, faturë tatimore nr. 120/2023, datë 19.04.2023, deklaratë “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, dokument bankar (pagesë qiraje), certifikatë konformiteti ISO 45001:2018, certifikatë konformiteti EN-ISO 9001:2015. Konkretisht konstatohet, se operatori ekonomik “FLESH” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 08.01.2024, me lëndë “Kthim - përgjigje kërkesës për sqarim lidhur me ofertën ekonomike anomalisht të ulët të paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, ku ka shpjeguar elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: “[...]Shtypshkronja Flesh ka realizuar me sukses në vitin 2022 prodhimin e diplomave për UMT, vërtetuar kjo me dokumentin që kemi paraqitur në dokumentet e tenderit, përfshi dhe modelet e diplomave të UMT që kemi dorëzuar në datën e hapjes. Për këtë arsye ne kemi gati lastrat, klishetë të cilat zënë një kosto të konsiderueshme për riprodhimin me cilësi dhe në kohë reale të diplomave.

Shtypshkronja Flesh merr përsipër kontaktet me të gjitha fakultetet për numrat e serisë, origjinalitetin e modeleve prodhimin paraprak të mostrave, si dhe transportin sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë.

Shtypshkronja Flesh disponon të gjithë makineritë e domosdoshme për prodhimin e diplomave si:

-Makineri për shtypin e diplomave Offset Heidelberg SM 52/2

-Makineri për numëror (shtyp i lartë) heidelberg

*- Makineri për shtypin e nxehtë, kuposjen dhe hologramin format 35*50*

-Printer digital color RICOH PRO C5100S

- Thike për prerjen e diplomave

Stafi ynë ka përvojën për prodhimin e tyre në mënyre cilësore dhe pa gabime.

Shtypshkronja FLESH është certifikuar ISO 9001-2015 nga AQSCERT që nga viti 19.03.2022 ISO 9001-2015 është një standard i njohur globalisht për menaxhimin e cilësisë. Ndihejmon organizatat e të gjitha madhësive dhe sektorëve të përmirësojnë performancën e tyre, të takojnë klientët.

3. Origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ana juaj, zbatueshmërinë e detyrimeve, q lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Shtypshkronja Flesh furnizohet nga furnitorë të njohur shqiptare me letër dhe materiale europiane të certifikuara për cilësinë e tyre.

Bojra printeri origjinalë RICOH të certifikuara nga CE.

Shtypshkronja FLESH ka marrë masat për mbrojtjen dhe sigurinë dhe kushtet e punonjësve si bombulat për shuarjen e zjarrit, kutinë e ndihmës së parë, instruktimin e punonjësve për sigurinë në punë etj.

Jemi të instruktuar nga AQSCERT dhe jemi dhe jemi të pajisur me certifikatën që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të shëndetit të sigurisë në punë ISO 45001:2018

Kjo certifikatë ofron një kornizë të njohur ndërkombëtarisht për menaxhimin e rreziqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai u mundëson organizatave të vlerësojnë sistematikisht....”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit që përmban ky dokumentacion rezulton, se nga ana e operatorit ekonomik “FLESH” SHPK është paraqitur tabela me emërtimin “kosto analitike për prodhimin e diplomave”, e cila përmban analizën e kostos për letër për prodhimin e diplomave vertikal me përmasa të letres (axb) 22.4 x 33.3 cm 300gr/m², letër për prodhimin e diplomave horizontal me përmasa të letres (axb) 22.4x33.3 cm 300 gr/m² super fine, klishe për formatin vertikal shtyp i nxehtë dhe kuposje, klishe për formatin horizontal shtyp i nxehtë dhe kuposje, lastra për dy variantet, bojë shtypi për prodhimin e diplomave si dhe numratorin me ngjyrë të kuqe, bojë e padukshme me sy të lirë për logon UMT, varak gold shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak silver, për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm lineare, varak i kuq për shtyp të nxehtë me bobina 70cm lineare, varak zi për shtyp të nxehtë me bobina 70 cm linere, hologram, bojë printeri, orë pune (shtyp, offset, shtyp i lartë numrator, shtyp i nxehtë varak, hologram, kuposje, prerje, paketim), orë pune printim digital, transport dhe lëvizje për shërbim të prodhimit të diplomave, shpenzime të domosdoshme për konsum të ulët, detyrime tatimore, paga për kohën përkatëse të prodhimit të diplomave, energji elektrike dhe ujë bazuar në konsumin mesatar të tre muajve

të fundit, qera objekti, tatim fitimi, fitimi, shpenzime të tjera të paparshikuara. Gjithashtu Komisioni konstaton se, nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik “FLESH” SHPK, rezulton, se operatori ekonomik Flesh SHPK ka paraqitur ofertë lëshuar nga shoqëria “4 E- Color” SHPK, datë 05.01.2024, faturë elektronike nr. 1508/2023, datë 1.05.2023, faturë tatimore nr. 120/2023, datë 19.04.2023, deklaratë “Listpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, dokument bankar (pagesë qiraje), certifikatë konformiteti ISO 45001:2018, certifikatë konformiteti EN-ISO 9001:2015. Komisioni konstaton, se oferta e lëshuar nga shoqëria “4 E- Color” SHPK për materialet bojë e zezë shtypi, bojë e kuqe shtypi, bojë e verdhë shtypi, bojë blu shtypi, bobinë varak i nxehtë gold, bobinë varak i argjend, bobinë holograme, bojë shtypi fluoeshente (e padukshme me sy të lirë), mban datën **05.01.2024**, ndërkohë procedura e prokurimit dhe dorëzimi i ofertës ekonomike është kryer në datë **28.12.2023**. Në këto kushte Komisioni gjykon, se referuar preventivit të zërave të ofruar, sipas parashikimeve në dokumentet e tenderit për zërat e sipërcituar nuk është paraqitur analizë kosto e detajuar duke justifikuar listën e çmimeve të ofruara në ofertën ekonomike, pasi dokumentacioni provues referuar materialeve të sipërpërmendura mban datën 05.01.2024 pas zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, operatori ekonomik “FLESH” SHPK, nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, nuk ka arritur të argumentojë elementet e ofertës së tij për të cilët autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime, siç parashikohet në nenin 93 të LPP-së si më sipër cituar, duke mos krijuar bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Flesh” SHPK me argumentin, se: *“OE Flesh shpk ditën dhe orën e hapjes së ofertave ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: Ofertuesi deklaron se:

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

III.2.2 Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “FLESH” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim për pagim detyrimesh nr. T09648571, datë 27.12.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtje *“...rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të paguar deri në datën 27.12.2023 ora 14:22:37”*

- Vërtetim (për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin-E-SIG 02/a), nr. T096552273, datë 28.12.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtjen si vijon “...nga të dhënat për kontributete e regjistruara në organin tatimor deri në datën 28.12.2023 që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 28.12.2023, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime, nga të cilat:
- Kontribute gjithsej: 0 lekë
- Kamatvonesa për kontributet: 0 lekë
- Gjoha lidhur me kontributet: 0 lekë[...]

III.2.3 Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje parashikimet e nenit 92 pika 3 dhe nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”:

“[...]3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. “[...]”

III.2.4. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje parashikimet e nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikat 2, 3 dhe 4:

“2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

III.2.5 Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton, se në shtojcën 7 kriteret e përgjithshme të kualifikimit përcaktohet, se *Operatori Ekonomik nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Flesh” ShPK pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton, se ky i fundit ka dorëzuar vërtetimet e lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me plotësimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, përkatësisht vërtetimin për pagim detyrimesh nr. T09648571, datë 27.12.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me përmbajtje nga e cila rezulton, se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën 27.12.2023 ora 14:22:37, si dhe vërtetimin (për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin-E-SIG 02/a), nr. T096552273, datë 28.12.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nga ku rezulton, se “...nga të dhënat për kontributet e

regjistruara në organin tatimor deri në datën 28.12.2023, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 28.12.2023, rezulton, se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime, nga të cilat: Kontribute gjithsej:0 lekë, Kamatvonesa për kontributet: 0 lekë, Gjoha lidhur me kontributet: 0 lekë[...]

Bazuar në nenin 11, të ligjit nr. 9163, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, afati për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është brenda datës 20 të muajit pasardhës. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Flesh” ShPK, me dokumentacionin e paraqitur, përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr.7, “kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, pasi vërteton shlyerjen e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas kërkesës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Flesh” SHPK me argumentin, se: “Gjithashtu mendojmë se OE FLESH shpk nuk ka paraqitur /dorëzuar në sistemin SPE të APP, një vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *Ofertuesi deklaron se:*

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.3.2. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• **I
n
f
o**

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

--	--	--	--

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata				
<i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i>				
<hr/>				
<i>etj.</i>				
<i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>				

<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i>				
<i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i>				
<i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo*

aspekt;

3. *Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
4. *Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
5. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
 - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
 - a) *çmimet ;*
 - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, o Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut I të seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin në të cilin zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, në përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër	Po [] Jo []

të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</i>	<u><i>Punonjës</i></u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse, po, numri i punonjësve:</i> <hr/> <i>Profili i punonjësve</i> <hr/> <u><i>Makineri e mjete</i></u> <i>Po [] Jo []</i> <i>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</i> <hr/>
<i>Emri, Mbiemri</i> _____ <i>Firma</i> _____ <i>Vula</i> _____ <i>Data e dorëzimit të deklaratës</i> _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- ***Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.***
- ***Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.***
- ***Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për***

përrjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.3.3 Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “FLESH” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit
- Vërtetim debie për operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për personat juridikë të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, lidhur me ndërtime të reja, nr. OSHEE-2023-3704477-XG, datë 14.12.2023 me përmbajtjen si vijon: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. F. H, vërtetojmë se kërkuesi FLESH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me kod TRIH030023157341, titullar i së cilës është K. F, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.12.2023, pa përfshirë faturën koherente të muajit nëntor 2023.

III.3.4 Në pikën 7 të nenit 40 “Kontratat e veçanta për kontratat e mallrave”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

- a) *operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

III.3.5. Në nenin 13 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që:

“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse”.

III.3.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.3.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.3.8. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “FLESH” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet, se është plotësuar sipas Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit.

III.3.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik “FLESH” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “Deklaratë Për për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “FLESH” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “FLESH” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, për skuafikimin e operatorit ekonomik “FLESH” SHPK, me anë të shkresës nr.154/6 prot., datë 08.03.2024, i kërkoi autoriteti kontraktor, në mbështetje të nenit 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik “FLESH” SHPK, i renditur i pari. Nëpërmjet shkresës me Nr. 3625/29 prot., datë 12.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 154/7 prot., datë 13.03.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Flesh” SHPK.

III.3.10 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, i dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “FLESH” SHPK, për të provuar deklaratimet e tij për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, konkretisht pikës e) në dokumentet e tenderit, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentet e noterizuara si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit
- Vërtetim debie për operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik, për personat juridikë të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, lidhur me ndërtime të reja, nr. OSHEE-2023-3704477-XG, datë 14.12.2023 me përmbajtjen si vijon: *“Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. F. H, vërtetohet, se kërkuesi FLESH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për*

kontratën me kod TR1H030023157341, titullar i së cilës është K. F, rezulton, të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.12.2023, pa përfshirë faturën koherente të muajit nëntor 2023.

Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në shtojcën 7, kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ të kualifikimit, ku përcaktohet se : Ofertuesi deklaron se: *e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar vërtetim OSHEE-2023-3704477-XG, datë 14.12.2023, me përmbajtjen si vijon: “Bazuar në deklaratimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) z. F. H, vërtetojmë se kërkuesi FLESH SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me kod TR1H030023157341, titullar i së cilës është K. F, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.12.2023, pa përfshirë faturën koherente të muajit nëntor 2023.*

III.3.11. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: *“11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”*

III.3.12. Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: *“13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”*

III.3.13. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “FLESH” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor një vërtetim sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “FLESH” SHPK nuk rezulton debitor për kontratën me kod TR1H0300231577341, titullar i së cilës është Krenar Fuga, vlerë e llogaritur deri më datë 14.12.2023, pa përfshirë edhe faturën e muajt nëntor 2023, ku referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 28.12.2023, nuk ka detyrime të papaguara, pasi sipas nenit 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht se: *“Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit, si dhe*

legjislaconit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t'i dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit..”, ndërsa në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit, si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”.

III.3.14. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Flesh” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor një vërtetim të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “FLESH” SHPK nuk rezulton debitor, pa përfshirë muajin e fundit ende të pamaturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, datë 28.12.2023. Gjithashtu, KPP gjykon, se institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Flesh” SHPK me argumentin, se: *“Në përputhje me LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik kërkojmë: Verifikimin dhe testimin e mostrave të paraqitura nga OE FLESH, nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, përsa i përket:*

- 1. Të gjithë elementëve përbërës dhe proceseve teknike si: përmasat, dizajni, ngjyra, relievi, elemnt sigurie etj., të përcaktuara në shtojcën 5, të DST:*
- 2. Llojit dhe peshës së letrës së Diplomave: “letër 300gr/m2 superfine”*

Pasi kemi bindjen që mostrat e paraqitura nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 dhe të kërkuara në shtojcën 7 të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në dokumentat e tenderit “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, është parashikuar:

- 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë ambjenteve të Rektoratit të UMT-së, një mostër diplome horizontale dhe një mostër diplomë vertikale, në të cilën të jenë integruar elementët dhe proceset teknike si dizajni, ngjyra, relievi, element sigurie, etj., duke krijuar nje produkt të ngjashëm me ato të kërkuara në specifikimet teknike në të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit. Mostra e kërkuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur.*

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.4.2. Në dokumentet e tenderit Shtojca 5, “Specifikimet teknike”, është parashikuar si vijon:

Shtojca 5

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- **Diplomat do të jenë me letër 300 gr/m², super-fine**
- **Formati vertikal**
 - b. **Përmasat**
 - me përmasa të letrës (a x b) - 22.4 x 33.3 cm.
 - me kornizë të jashtme (perimetrale) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.
 - me kornizë të brendshme (perimetrale) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.
 - me kornizë të brendshme (perimetrale) në ngjyre argjendi, me gjerësi 3 mm.
 - me kornizë të brendshme, ku do të realizohen printimet, me përmasa (a x b) – 17.0 x 27.9 cm.
- **Formati Horizontal**

a. Përmasat

- *me përmasa të letres (a x b) – 33.3 x 22.4 cm.*
- *me kornizë të jashtme (perimetrare) me ngjyrë blu, me gjerësi 2.3 cm.*
- *me kornizë të brendshme (perimetrare) me ngjyrën e letrës, me gjerësi 1 mm.*
- *me kornizë të brendshme (perimetrare) në ngjyre floriri, me gjerësi 3 mm.*
- *me kornizë të brendshme, ku do te realizohen printimet, me përmasa (a x b) – 27.9 x 17.0 cm.*

- Printimet mbi karton:

- *Printim i dixhitalizuar i të dhënave në Diplomë me 4 ngjyra LASER-cmyk (kategorikisht jo printime ink). Sfond 97-98 % 4-color-cmyk, hapësira e printimit mbi karton sipas përcaktimeve të formateve horizontale dhe vertikale.*
- *Mbi të gjithë sipërfaqen vendoset një shtresë e konfiguruar Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Republika e Shqipërisë me shkrim të minimizuar që nuk lexohet me sy të lirë, duke veshur të gjithë pjesën e bardhë të diplomës*
- *Nr.serie me ngjyrë të kuqe, Nr. i diplomës së studimeve të mëparshme dhe Nr. unik i identifikimit të diplomës me ngjyre te zezë.*

- Stampimet mbi karton:

- *Logo e Republikës duhet të jetë me tre ngjyra, stampim i nxehte (varak).*
- *Stampimi i emërtesës DIPLOMË (1cm x 6,5 cm), me thellësi të goditjes 0,5 mm*
- *Stampimi i emërtesës DEKANI (0,4cm x 2 cm) dhe REKTORI (0,4cm x 2,2cm) me thellësi të goditjes 0,5 mm.*
- *Shiriti i kornizës së brendshme (perimetrare) me gjerësi 3 mm me stampim të nxehtë dhe kuposje.*

- Elemente sigurie:

- *Logo e UMT-së, formati 2,2 cm x 1cm në fund të kartonit (si në modelin e skanuar bashkëlidhur) holograme me refleks ngjyrë argjendi në diplomat vertikale dhe me refleks ngjyrë floriri në diplomat horizontale.*
- *Në sipërfaqen e diplomës të vendoset logo U-Vizibël me përmasa 12 cm x 5 cm. Të gjitha elementet shfaqen me refleks të ndryshueshme sipas planit të shikimit.*
- *Pulla duhet të ketë elemente sigurie të dukshme dhe të maskuar (holografikë dhe joholografikë) që sigurojnë vlerësimin e origjinalitetit të saj Ngjitje holograme 2-color rrethore φ 25 mm. Pulla përgatitet me material vetë-ngjitës, që priset nëse tentohet të çngjitet;*

- Të dhënat e hologramës(pulla) si më poshtë:

- *Në Diplomate vertikale pulla ka formë rrethore me diametër φ 25 mm, ngjyrë argjendi dhe me goditje gërmat UMT. Gërmat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë argjendi;*
- *Në Diplomate horizontale pulla ka formë rrethore me diametër φ 25 mm, ngjyrë floriri dhe me goditje gërmat UMT . Gërmat UMT kanë orientim në 2 dimensione të cilat evidentohen sipas refleksionit, ngjyrë floriri;*

III.4.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.4.5 Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen

ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.4.6. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, në pikën 2.3.3 të Kapacitetit teknik, rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë një mostër diplome horizontale dhe një mostër diplomë vertikale, në të cilën të jenë integruar elementët dhe proceset teknike si dizajni, ngjyra, relievi, element sigurie, etj., duke krijuar një produkt të ngjashëm me ato të kërkuara në specifikimet teknike në të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit. Mostra e kërkuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur. ***Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik.***

III.4.7. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik akimues, referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, KPP konstatoi, se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostra konkretisht, një mostër diplome horizontale dhe një mostër diplomë vertikale. Sa më sipër, referuar pretendimeve e operatorit ekonomik ankimues për testimin e këtyre mostrave, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, që operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër diplomë horizontale dhe një mostër diplomë vertikale, duke integruar specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5, duke krijuar një produkt të ngjashëm me ato të kërkuara në specifikimet teknike, pra rezulton se mostra e kërkuar nuk është produkti përfundimtar, por i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Akoma më tej, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 154/8 prot., datë 05.04.2024, iu drejtua laboratorit Eko Studio Projekt SHPK me kërkesën për informacion lidhur me kryerjen e analizave të materialeve (diplomë format vertikal dhe diplomë format horizontal) nëse ndikon në peshën e letrës, në rastin kur letra është e stampuar, duke renditur edhe specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit. Me shkresën nr. 347 prot., datë 19.04.2024 laboratorit “Eko Studio Projekt” SHPK, ka dërguar informacionin si vijon: “...nisur nga elementet shtesë mbi karton si printimet, stampimet, logot dhe holograma mbi karton, mund të ndikojnë në disa mënyra lidhur me peshën e letrës:

Printimi mbi karton mund të ndikojë në disa mënyra:

Cilësia e imazhit: Nëse printimi është i një cilësie të lartë dhe përdor shume ngjyra të dendura ose grafika komplekse, kjo mund të rrisë peshën e kartonit. Ngjyra e bojës: Për përdorimin e ngjyrave të ndryshme, vecanërisht atyre të ndritshme dhe të dendura, mund të nevojitet kjo shtesë e madhe boje për të arritur ngjyrën e dëshiruar, duke shtuar kështu peshën e kartonit. Ndërveprim me materialin: Disa lloje bojërash mund të përshkruhen thellë në sipërfaqen e kartonit, duke e bërë atë të duket më e trashë ose të ndihet më e ngurtë.

Struktura e materialit: Duhet të kemi parasysh që materiali super fin i kartonit ka një strukturë shumë të hollë dhe cilësia e printimit ndikon në dukjen e prgjithshme të kartonit.

Stampimi në karton mund të ndikojë në disa mënyra:

Përmbajtja e bojës: Nëse stampimi përfshin grafika të dendura ose tekst me bojë të trashë, kjo mund të rrisë peshën e kartonit. Sasia e bojës: Për disa lloj stampimesh sic është stampimi offset, aplikimi i sasissë së madhe të bojës mund të shtojë në peshën e kartonit.

Ngjyra e bojës: Nëse aplikohet një shtresë e madhe boje ose ngjyra të shndritshme dhe të dendura, kjo mund të shtojë në peshën e kartonit. Përpunimi i stampimit: Teknikat e stampimit, sic janë prerja ose formimi i ngjyrave mund të ndikojë në strukturën dhe peshën e kartonit.

Referuar aplikimit të elementeve të sigurisë logos UV mbi karton ky element ndikon në disa mënyra:

Peshimi: Aplikimi i një logoje UV mund të ndikojë në peshën e letrës nëse përdoret një sasi e madhe boje për të arritur efektin e dëshiruara. Ngjyra e bojës: Nëse logoja UV aplikohet me sasi të madhe boje ose ngjyra të dendura, kjo gjithashtu mund të ndikojë në peshën e kartonit.

Ndërveprimi me materialin: Aplikimi i një logoje UV mund të ndikojë në teksturën e sipërfaqes së kartonit, duke e bërë atë më të trashë në dukje ose në prekje më të ngurtë.

Rezistenca ndaj ndryshimeve të temperaturës: Materiali super fin mund të ketë një ndjeshmëri ndaj ndryshimeve të temperaturës, kështu që aplikimi i tyre duhet të bëhet me kujdes për të minimizuar ndikimin e tyre në cilësinë dhe peshën e kartonit.

Referuar aplikimit të halogramës (pullës) mbi karton material super fin, ky element mund të ndikojë në disa mënyra:

Peshimi: Aplikimi i pullave mund të shtojë pak në peshën e kartonit, vecanërisht nëse pullat janë të përforcuara me materiale shitesë ose bojë. Ngjyra e pullave: Nëse pullat aplikohen me ngjyra të shndritshme ose ngjyra të dendura, kjo gjithashtu mund të ndikojë në peshën e kartonit. Struktura e kartonit: Aplikimi i pullave mund të ndikojë në strukturën e sipërfaqes së kartonit, duke e bërë atë të duket më e trashë ose në prekje më e ngurtë. Rezistenca ndaj ujit: Nëse pullat aplikohen me produkte që kanë ndikim në strukturën e kartonit, kjo gjithashtu mund të ndikojë në rezistencën e kartonit ndaj ujit.

KPP referuar përgjigjes së laboratorit “Eko Studio Projekt” SHPK, konstaton, se mostrat e paraqitura nuk mund t’i nënshtrohen procesit të testimit për sa kohë elementët e stampimit, printimit do të ndikonin në peshën e letrës së përdorur. Akoma më tej, Komisioni rithekson, se ashtu siç është përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, operatori duhet të dorëzojë mostrat **duke krijuar një produkt të ngjashëm** me ato të kërkuara në specifikimet teknike, konkretisht mostrat e dorëzuara i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Inpress” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-91142-12-15-2023 me objekt: “Prodhim dhe printim diplomash për njësitë shpenzuese të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 1,484,255.00 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) leke pa TVSH, zhvilluar më datë 28.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Flesh” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro